

**Qendra profesionale Nxitja e Hershme** angazhohet për arsimimin, këshillimin dhe edukimin e fëmive të vegjël deri në moshën parashkollore. Ajo ju garanton një ofertë të shumëanshme dhe të nevojshme për të gjithë familjet në qytetin e Schaffhausenit. Qendra profesionale përkujdeset për kushte të mira dhe kualitative të qendrave këshilluese. Ajo informon, koordinon dhe lidh personat dhe organizatat në zonat urbane. Qyteti i Schaffhausenit i vendos fëmijët dhe familjet e tyre në qendër të vëmendjes dhe angazhohet për një politikë të tërësishme për fëmijët që nga mosha e hershme.

**Ne jemi këtu me gjithë qef për ju!**

Fachstelle Frühe Förderung, Fronwagplatz 24, 8201 Schaffhausen

+41 52 632 53 51 | [info@ff-stsh.ch](mailto:info@ff-stsh.ch)

Ludhëheqsja e qendrës profesionale: Kathrin Borer

**STADT-SCHAFFHAUSEN.CH**

Stadt Schaffhausen

Fachstelle Frühe Förderung

Fronwagplatz 24

Postfach 1000

CH-8201 Schaffhausen

[info@ff-stsh.ch](mailto:info@ff-stsh.ch)

**TË MËSUARIT FILLON NË FAMILJE**



# TË MËSOSH QË NË VEGJËLI

Fëmijët nuk fillojnë të mësojnë në shkollë apo në parashkollore, por shumë më herët. Kjo fletushkë ju jep ide, se si ju mundeni t'ua lehtësoni fillimin në parashkollore fëmive juaj: me anë të lojës, lëvizjeve në natyrë ose të punuarit me dorë. Familja është vendi më i përshtatshëm për të mësuar.

## A e keni ditur që, Fëmijët ...

- duke e zbratur rërën nga një enë në tjetrën mbledhin njohuri matematikore?
- duke parë libra me fotografi ushtrojnë koncentrimin?
- duke zhgaravitur vija të thjeshta ato ushtrojnë motorikën e vogël e cila ju nevojitet për të shkruajtur?

Informacione dhe ide të tjera do të gjeni në Webfaqen tonë [www.ff-stsh.ch](http://www.ff-stsh.ch).

Ju dëshirojmë shumë momente të këndshme dhe të vlefshme me fëmijët tuaj!

# KOMUNIKATIONI

## TË FOLURIT, TË DËGJUARIT, TË KUPTUARIT

### – Flisni me fëmion tuaj?

- » Në këtë mënyrë fëmion tuaj mëson ta kuptoj dhe ta flasë gjuhën e nënës. E cila paraqet një bazë themelore për gjuhët tjera.

### – Shikoni bashkë libra me fotografi?

- » Fëmija juaj kështu mëson të dëgjojë dhe të koncentrohet. Më vonë kjo do ti ndihmojë që më lehtë të mësojë të lexoj dhe të shkruaj.

### – I emërtoni gjësendet në jetën e përditshme?

- » Fëmija juaj mëson, kur ju ia tregoni dhe ia sqaroni mjedisin ku jeton. Kështu ai mundet të kuptoj më mirë gjërat dhe rrjedhojën e tyre.



# PËRVOJA

## PËRJETOHET, TË KUPTUARIT, EKSPLOARIMI

### – A dilni me fëmion tuaj në natyrë?


- » Fëmija është kurioz dhe dëshiron që ta kuptoj botën. Në natyrë ai ka mundësi të eksploaroj/vëzhgojë dhe përjetojë gjëra dhe aventura të reja.

### – E lejoni fëmion të eksperimentojë me kubat?

- » Me anë të tyre fëmion i kupton format, madhësin dhe shumën. Kjo njohuri i ndihmon më vonë gjatë llogaritjes.

### – Guxoni fëmion tuaj të prekë materiale të ndryshme?

- » Gjatë eksploatimit fëmion tuaj guxon edhe të zhytet/përlyhet. Gjatë kontaktit me ujë dhe tokën/dhenë ai fiton përvoja të reja.



# KREATIVITETI

## FORMIMI/DIZAJNIMI, TË PROVUARIT, TË NJOFTUARIT

### – E lejoni fëmion tuaj të punojë me letër dhe ngjyra?

- » Vizatimi dhe dizajnimi e argëtojnë fëmion tuaj. Ashtu ai mëson t'i lëvizë duart e tij më mirë.

### – A guxon fëmion tuaj të përdorë gërshërët?

- » Duke provuar fëmion tuaj mëson vetvetiu: Lejoni fëmion të eksperimentojë, edhe nëse nuk ecën që në fillim ashtu siqë duhet.

### – Një fëmion tuaj materiale të ndryshme?

- » Punimi me plastelin, pambuk, plëhura dhe materiale të tjera e nxisin fantazinë e fëmijës. Ashtu ai mëson me të gjitha shqisat.



# PAVARËSIA

## TË NDIHMUARIT, TË SHKËPUTURIT, TË BËMURIT VETË

### – Ju ndihmon fëmion tuaj gjatë punëve të përditshme?

- » Fëmija dëshiron që të inkuadrohet në punët e shtëpisë. Atëherë ai e ndjen vehten, që ju përket juve dhe që ju e merrni atë seriozisht.

### – Duhet fëmion tuaj ndonjëherë të jetë i ndarë për ca orë nga ju?

- » Nëse fëmion tuaj qëndron vetë tek një shok, atëherë ai mëson të shkëputet nga ju. Dhe kjo ia lehtëson atij fillimin në parashkollore.

### – Guxoni fëmion tuaj të bëjë vetë diçka, edhe pse ajo mund të zgjasë shumë gjatë?

- » Fëmion tuaj dëshiron shumë gjëra të bëjë vetë: të hajë, të mbathë këpucët, ... dhe për këtë nevojitet kohë dhe durim. Por kështu fëmija do të bëhet i pavarur.



# KOMUNITETET

## TAKIMET, TË LUAJTURIT, TË PËRSHTATURIT

### – Takon fëmion tuaj rregullisht fëmijë të tjerë?

- » Të grindet dhe përsëri të pajtohet mëson fëmion tuaj gjatë takimeve me të tjerët. Kështu ai mund të integrohet në një grup.

### – Di fëmion tuaj të ju përmbahet rregullave?

- » Fëmion tuaj mëson shumë gjatë lojrave me fëmijë të tjerë. Ai ashtu mëson si t'i respektojë të tjerët dhe si të mbizotërojë.

### – Është fëmion tuaj i mësuar që të ndaj me të tjerët?

- » Të ndajsh, t'iu ndihmohet të tjerëve dhe të jeshë i hapur për ide të reja, këto fëmija më së miri i mëson në kontakt me shokë.

